



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT TË BURIMEVE
NATYRORE
DREJTORIA MINERARE DHE INDUSTRIALE

URDHËR

Nr. 302 , datë 12 . 4 .2011

PËR

MIRATIMIN E PARIMEVE BAZË PËR HARTIMIN E PLANIT TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT, TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË MBYLLJES SË VEPRIMTARISË MINERARE, TË MËNYRËS SË PËRCAKTIMIT TË ZONËS SË RREZIKSHME TË NJË TË DREJTE MINERARE DHE TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE MINERARE

Në zbatim të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 37, pika 1 dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedis mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:
 - a) Zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarive minerare në respekt të ambientit dhe të certifikuar nga komuniteti, duke mbrojtur pasuritë natyrore për të siguruar plotësimin e nevojave aktuale pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm, për të plotësuar nevojat e tyre, si dhe duke bërë të mundur ruajtjen afatgjatë të cilësisë së mjedisit dhe diversitetit biologjik të tij.
 - b) Interesit publik për një veprimtari minerare ku vendimmarrja bëhet në kushtet e transparencës, paraprihet nga këshillimet me komunitetin e zonës dhe mendimin me shkrim të njësive përkatëse të qeverisjes vendore.
 - c) Dallimit dhe pavarësisë të së drejtës minerare nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, duke garantuar pronësinë e shtetit mbi mineralet dhe ruajtur pronësinë e sipërfaqes ku këto minerale gjenden, duke përcaktuar marrëdhënien ndërmjet këtyre të drejtave me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi.
 - d) Marrjen e masave paraprake, për parandalimin, apo në rast se nuk është e mundur minimizimin e dukurive e efekteve negative në mjedis dhe garantimin e marrjes se masave efektive në kohë dhe me kosto me të ulët.

- e) Ruajtjes së Pasurive Natyrore gjate veprimtarive minerare që përfshin mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së burimeve natyrore; ajrit, ujit, detit, tokës, pyjeve, biodiversitetit dhe diversitetit të peizazhit natyror.
 - f) Zëvendësimit dhe/ose kompensimit që nënkupton masat, që duhet të merren për të zëvendësuar çdo ndërhyrje që mund të sjellë efekte të dëmshme mbi mjedisin, për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira, përdorimin e produkteve, pajisjeve dhe aparaturave, si dhe zbatimin e atyre proceseve të prodhimit, të cilat janë më pak të dëmshme apo të pa dëmshme për mjedisin.
 - g) Qasjes së ntegruar që garanton një zhvillim të balancuar ekonomik, parandalon rrezikun ndaj mjedisit dhe/ose redukton këtë rrezik në tërësi, nëpërmjet planifikimit të territorit, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë cënueshmërisë së mjedisit në vendin specifik, lidhjes ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjes ndërmjet pasurive natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme, trashëgimisë kulturore dhe pasurive materiale, tërësisë së ndërveprimeve të tyre reciproke, si dhe ndërveprimit ndërmjet pasurive materiale ekzistuese dhe atyre të planifikuara.
 - h) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore dhe sigurimit të këtij bashkëpunimi në rang rajonal dhe më gjërë, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkufitare, ndërqeveritare dhe ndërkombëtare.
 - i) Ndotësi paguan për veprimet ose mosveprimet, të cilat rezultojnë në dëmtimin e mjedisit apo në rrezikun e dëmtimit të mjedisit duke vendosur përgjegjësitë financiare për të eliminuar këtë dëmtim. Kosto të tilla mund të përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si edhe kostot e mënjanimit të dëmtimit të mjedisit, duke përfshirë edhe kostot e rehabilitimit dhe të kompensimit ose dëmtimet e shkaktuara ndaj të tretëve, nga zotëruesi i lejes minerare.
 - j) Aksesit ndaj informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut, duke garantuar që çdo person ka të drejtë të marrë në kohë informacion mbi ndotjen e mjedisit, masat e marra për eliminimin e kesaj ndotje apo demtimi të mjedisit.
 - k) Promovimit të të gjithë atyre veprimtarive, të cilat parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e mjedisit, si edhe projekteve, të cilat sjellin pakësimin e përdorimit të substancave, lëndëve të para dhe energjisë, apo të cilat e ndotin mjedisin në një masë më të vogël.
2. Parimet bazë për hartimin e planit të të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare mbështeten në legjisllacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:
- a) Mbylljes progresive të veprimtarisë minerare.
 - b) Garantimit të mbylljes së sigurtë të veprimtarisë minerare
 - c) Garantimit të demolimit të sigurtë të objekteve të veprimtarisë minerare, që nuk mund të përdoren me tej pas përfundimit të kësaj veprimtarie, sipas përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi.
 - d) Realizimit të përfundimit të procesit të mbylljes së objekteve minerare të ish ndërmarrjeve shtetërore minerare.
 - e) Garantimit të një procesi mbyllje me një emetim sa më të vogël në mjedis dhe garantimit të monitorimit postminerar.
 - f) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore.
 - g) Rehabilitimit të pjesëve të dëmtuara të mjedisit;
3. Parimet bazë për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare së veprimtarisë minerare mbështeten në legjisllacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:

- a) Qëllimit të ndotjes së nivelit më të ulët në tokë, në ujërat, të flora e fauna dhe në ekosistemin, në përgjithësi, dhe në përputhje me vlerat minimale, të pranuar sipas legjislacionit në fuqi.
 - b) Promovimit dhe inkurajimit të proceseve të riciklimit, që sasia e depozituar e mbetjeve të jetë sa më e vogël.
 - c) Garantimit të një vendi dhe mënyre depozitimi të mbetjeve në mënyrë të sigurtë që ato të mos përbejnë rrezik për mjedisin e komunitetin në të ardhmen, duke respektuar kërkesat mjedisore dhe kërkesat e shkarkimeve, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mjedisin.
 - d) Garantimit të një një emetimi minimal të shkarkimeve të elementeve të dëmshëm në mjedis.
 - e) Trajtimit të mbetjeve minerare sipas karakteristikave të tyre, përbërjes, dekompozimit.
 - f) Inkurajimit të përdorimit të produkteve më miqësore ndaj mjedisit dhe teknikave më të mira të disponueshme;
 - l) Parandalimit dhe marrjes së masave paraprake në mënyrë që të eliminojnë ngjarjet aksidentale dhe parandalojnë apo në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë dukurinë e efekteve negative në mjedis dhe të garantojnë marrjen e masave efektive në kohë dhe me kosto më të ulët.
 - g) Garantimit të monitorimit të efekteve të mbetjeve nëpërmjet vazhdimësisë së monitorimit dhe mbajtjes së një informacioni të hollësishëm për punimet e kryera për depozitimin dhe për trajtimin e mbetjeve minerare.
 - h) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore.
 - i) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik;
4. Parimet bazë të përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:
- a) Garantimit të realizimit të veprimtarive minerare në mënyrë të sigurtë, duke eliminuar rrezikun minerar.
 - b) Garantimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve të zonës përreth zonës minerare.
 - c) Përcaktimeve të sakta të kontureve të zonës së rrezikshme të një leje minerare duke marrë në konsideratë efektin e veprimtarisë minerare, si punimet e shpim-plasjes, emetimit të shkarkimeve, zhurmën, pluhurin, depozitimit të mbetjeve, përpunimin e mineralit.
 - d) Garantimit të dëmtimeve të mjedisit, infrastrukturës dhe objekteve të palëve të treta.
 - e) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore.
5. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen institucionet e SHGJSH dhe AKBN.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

ASIP NAÇO

